



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13233 Prot

Lezhë, më 22 / 07 /2022

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja “a” dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës (Korrik 2022)** të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e **martë**, në datën **26.07.2022**, në orën **11:00**, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, me këtë

REND DITE:

1. Projekt-Vendim “Për heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ernest Rakaj”
2. Interpelancë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore kërkuar nga këshilltari Agostin Marku
3. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Qershor 2022”
4. Projekt-Vendim “Për një shtesë në VKB nr. 5, datë 28.01.2020 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit””
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit Gj.Ç dhe T.N nga fondi i emergjencës”
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2023-2025 (Faza e dytë) të Bashkisë Lezhë”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit të Shlyerjes së Detyrimeve të Bashkisë Lezhë”
8. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej, pasi kanë dalë të pastreha si shkak i dëmtimit të banesave nga rrëshqitja e dherave”
9. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni Juridik	E hënë	25.07.2022	10:00
2	Komisioni i Mirëqenies Sociale	E hënë	25.07.2022	10:15
3	Komisioni i Shërbimeve Publike	E hënë	25.07.2022	10:30
4	Komisioni i Ekonomisë dhe Financave	E hënë	25.07.2022	10:45
5	Komisioni i Sigurisë Publike dhe Emergjencave	E hënë	25.07.2022	11:15

